

Breaking News:

DVP Korçë/Masa për garantimin e rendit dhe sigurisë gjatë Maratonës Kombëtare dhe Ndërkombëtare, që do të zhvillohen më datë 25.07.2026





24/07/2026

DVP Tiranë/Finalizohet Operacioni I Koduar “Risku”, Kapet 1 Shtetas Që Mbante Armë Zjarri

DVP Tiranë/Finalizohet operacioni i koduar “Risku”, për kapjen e shtetasve të armatosur, të cilët përbëjnë rrezik për kryerje të ngjarjeve kriminale kundër personit.

Arrestohet në fshatin Bërxullë, një 43-vjeçar që mbante pa leje, në banesë, pistoletë me municion.

Sekuestrohen arma e zjarrit, si dhe krehri i saj, me 7 fishekë.

Si rezultat i punës parandaluese, të bazuar në kontrole, hetime dhe informacione operative, me objektiv goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, si dhe identifikimin dhe ndalimin e shtetasve të cilët dyshohen për përfshirje në ngjarje kriminale, specialistët e Sektorit për Hetimin e Krimeve të Rënda finalizuan operacionin e koduar “Risku”, gjatë të cilit, në zbatim të vendimit të Gjykatës, u krye kontroll në banesën e shtetasit J. K., 43 vjeç, në fshatin Bërxullë.

Në banesë u gjet 1 armë zjarri pistoletë, me krehër dhe 7 fishekë, që posedohej pa leje, nga 43-vjeçari, i cili në vijim të veprimeve procedurale, u arrestua në flagrancë, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”

Kontrollet dhe verifikimet vijnë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

◀ Policia e Shtetit/Njoftim

DVP Korçë/Masa për garantimin e rendit dhe sigurisë gjatë Maratonës Kombëtare dhe Ndërkombëtare, që do të zhvillohen më datë 25.07.2026 ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

 GET IT ON
Google Play

 Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

>

Arkiva

>

Akademia e Sigurisë

>

Ministria e Brendshme

>

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

>

Interpol

>

Europol

>

Misioni PAMECA V

>

SCPA

>

Projekti Trivalent